



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 5 mars, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Isni Kilajt, pasi konstatoi se ekziston rreziku se mund të pengojë ecurinë e procesit penal dhe të kryejë vepra penale të tjera, si dhe rrezik i moderuar që mund të arratiset.

Z. Kilaj u arrestua si i dyshuar më 2 nëntor 2023, në Kosovë, nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë të nesërmen, në bazë të urdhrorit për transferim të lëshuar nga Gjykatësi i Vetëm i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Në bazë të Rregullores së Procedurës dhe Provave, kur një person i dyshuar ose i akuzuar paraburgoset, gjykatësi duhet të rishikojë çdo dy muaj nëse arsyet që përligjin paraburgimin e tyre janë ende të vlefshme. Sa u përket të dyshuarve, kohëzgjatja e gjithsejtë e paraburgimit përpara se Prokuroria të dorëzojë aktakuzën nuk mund të zgjasë më shumë se një vit dhe, gjatë asaj periudhe, çdo kërkesë për shtyrje dymujore duhet të përligjet prej masave hetimore që do të ndërmerren prej Prokurorit të Specializuar.

Në Vendimin e 5 marsit, Gjykatësi po ashtu përsëriti se ekziston dyshimi i bazuar se z. Kilaj mund të ketë kryer krime kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare. Gjykatësi vuri në dukje se këto konstatime lidhen me materialet konfidenciale të sekuestruara nga Prokuroria gjatë kontrollimit të kryer me autorizim gjyqësor në banesën e z. Kilaj, për të cilat ekziston dyshim i bazuar se ose do të përdorshin ose faktikisht u përdorën me qëllim ndërhyrjen në administrimin e drejtësisë.

Seancat në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit janë planifikuar të rifillojnë të hënën e ardhshme, më 18 mars në orën 9:00. Deri tani në këtë gjykim kanë dhënë dëshmi 48 dëshmitarë.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

